



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:259683

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05740920

KPPP.nr. 2001/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit K.N.P.SH “Papenburg & Adriani Company” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810652942 dhe me seli në Lipjan, rr. “Ibrahim Rugova”, fshati Grackë e Vjetër, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Hejredin Leka, avokat nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 548/23 i datës 10.11.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Arifi nga Gjilani, jashtë seancës me datën 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 548/23 i datës 10.11.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Arifi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit K.N.P.SH “Papenburg & Adriani Company” Sh.P.K., me datë 10.11.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 548/23, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. P200 6/23, e datës 21.06.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që nga dita e pranimit të urdhrin, sipas faturës së lartcekur t’ia paguajë kreditorit shumën prej EUR 116,788.23 si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor nuk është bashkangjitur në dosje të lëndës e me të cilën do të vërtetohej se e njëjta është nënshkruar

nga ana e debitorit. Ka shtuar se të metat në fatura si dokument i besueshëm paraqesin shkak që urdhri të anulohet. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsyetim se i njëjti prapësimin e tij e ka paraqitur duke mos u bazuar në asnjërin nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet i njëjti, në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është hartuar konform nenit 29, par. 3 të LPP-së dhe paraqet dokument të përshtatshëm për përmbartim. Ka shtuar se në shkresat e lëndës ka bashkangjitur edhe prova të tjera, e ndër të tjera edhe kontratën publike kornizë, ku janë përmbushur të gjitha detyrimet sipas sasisë, cilësisë dhe brenda afateve të përcaktuara me kontratë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimorë ta vërtetojë.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. P200 6/23, e datës 21.06.2023, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga vula e protokollit të debitorit si institucion publik, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbaerim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbaerimit pasi që është e përshtatshme për përmbaerim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se fatura në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbaerimor nuk është e përshtatshme për përmbaerim pasi që nuk përmban situacionin e punimeve të kryera mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se vet zyrtarët e debitorit, përmes shkresës me nr. të referencës 06 nr. 422/01-127723/23, kanë konstatuar kryerjen e punimeve nga kreditori për debitorin, dhe kanë njoftuar debitorin për detyrimin lidhur me përmbushjen e obligimit ndaj kreditorit në shumë prej 116,788.23 EUR, dhe atë në emër të situacionit të gjashtë (VI) përfundimtar në procedim për pagesë.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet tjera të debitorit të ngritura në prapësim por vlerësoi se të njëjtat nuk paraqesin asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaerimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2001/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.